

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**Njoftim për vend të lirë pune**

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", shpallet konkursi për 1 vend vakantë, pozicioni "Shofer Institucioni", personel mbështetës, pranë Sektorit të Shërbimeve; Drejtoria e Fondit të Investimeve dhe Shërbimeve".

SHOFER**I. Kriteria të përgjithshme:**

Kandidatët për pozicionin "Shofer", duhet të plotësojnë këto kriterë të përgjithshme:

- a. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- b. Të zotërojnë aftësitë profesionale specifike për vendin e punës për të cilin konkurojnë;
- c. Të kenë aftësitë e komunikimit profesional;
- d. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;
- e. Të mos kenë lidhje familjare (bashkëshort/ bashkëjetues, bir, bijë dhe fëmijet e tyre); gjinie (prindër, motër, vëlla dhe fëmijet e tyre), me punonjës brenda të njëjtës njësi ku kërkojnë të punësohen, si dhe të mos jenë në kushtet e konfliktit të interesave sipas ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", (i ndryshuar).
- f. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna dhe nuk është provuar largimi i padrejtë me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- g. Të mos kenë dëmtuar publikisht imazhin e USH-së.

II. Kriteret specifike:

Kandidatët për pozicionin "Shofer", duhet të plotësojnë këto kriterë specifike:

1. Kandidati duhet të zotërojë minimalisht diplomë të shkollës së mesme.
2. Të zotërojë patentë të kategorisë B.
3. Të ketë disponueshmëri për të punuar jashtë orarit zyrtar të punës;
4. Preferohet që kandidatët:
 - të kenë eksperiencë pune të ngjashme;
 - të ketë sjellje serioze dhe aftësi të mira komunikimi;

III. Dokumentacioni:

Kandidatët për pozicionin "Shofer", duhet të dorëzojnë me postë drejtuar Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kërkesë me shkrim për punësim në USH.
- b. Jetëshkrim (CV) me foto personale.
- c. Kopje e noterizuar e diplomës së shkollës së mesme.
- d. Dëshmi e gjendjes gjyqësore, vërtetim gjykate dhe vërtetim nga prokuroria, të lëshuara brenda 3- muajve të fundit.

- e. Raport mjeko-ligjor për aftësi në punë të lëshuar brenda 3- muajve të fundit.
- f. Kopje e noterizuar e librezës së punës dhe/ose çdo dokumentacion tjetër ligjor, që provon eksperiencën në punë, nëse ka.
- g. deklaratë personale që dëshmon për moslidhje familjare, (neni 5, pika 3/c) dhe që kandidati nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, (i ndryshuar).
- h. Fotokopje e pasaportës ose kartës ID dhe patentës tipi B.

V.O:

- Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë dokumentacionin e mësipërm bashkë me një listë përmbledhëse të këtij dokumentacioni të firmosur, brenda 14 ditëve kalendarike nga publikimi i njoftimit në Buletinin e Agjensisë së Prokurimit Publik.

Mosplotësimi i kriterëve të përcaktuara apo mosdorëzimi i dokumentacionit të kërkuar në këtë shpallje, (me përjashtim të kriterëve të përcaktuara si preferenciale) përbën shkak për skualifikimin e kandidatëve.

- Konkursi do të zhvillohet në dy faza:

Faza I: Vlerësimi i dokumentacionit dhe;

Faza II. Intervista me gojë.

- Kandidatët do të njoftohen me e-mail nga kryetari i komisionit ad-hoc për kualifikimin apo skualifikimin e tyre.

- Ankimimet mund të bëhen brenda 5 (pesë) ditëve punë nga shpallja e rezultatit.

SPITALI UNIVERSITAR I TRAUMËS

Njoftim për vend të lirë pune

Në zbatim të VKM-së Nr. 176, datë 29.03.2006, “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”, shpall konkursin për 1 (një) vend të lirë pune, në Spitalin Universitar të Traumës.

1 Vend vakant në Pozicionin “Operator” në Sektorin e Koordinimit me Pacientin.

Kandidatët për vendin vakant “Operator” duhet të plotësojnë këto kriterë:

1. Të kenë përfunduar arsimin e mesëm.